



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.140 dt.29.09.1997

PER
PLANIFIKIMIN E PERDORIMIT TE TE ARDHURAVE PER VITIN 1997.

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.29.09.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Financës, mbështetur në Ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin e funksionimin e Pushtetit Lokal në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre,

VENDOSI

1. Të miratojë detajimin e planit të përdorimit të të ardhurave për shpenzime operative në shumën 150 milion lekë sipas pasqyrës bashkëngjitur.
2. Të miratojë realizimin e shpenzimeve operative nga të ardhurat për periudhën 7 – mujore sipas pasqyrës bashkëngjitur.
3. Të miratojë detajimin e planit të të ardhurave për investime për shumën 25 milion lekë sipas pasqyrës bashkëngjitur.
4. Të miratojë realizimin e investimeve nga të ardhurat për periudhën 7 – mujore sipas pasqyrës bashkëngjitur.
5. Ngarkohet Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI